

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Mars



01

KUVENDI MIRATON NDRYSHIMET NË LIGJIN "PËR RININË" – MUNDËSI TË REJA PËR TË RINJTË

Në Kuvend u miratua Projektligji me disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin "Për Rininë", duke sjellë një kuadër më të avancuar dhe të harmonizuar me standardet evropiane. Pas diskutimeve dhe shqyrtimit të projektligjit nga Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioni për Çështjet Evropiane dhe Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë – Projektligji mori edhe miratimin përfundimtar të Kuvendit me 71 vota pro. Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, e cilësoi këtë si një hap kyç për mbështetjen dhe aktivizimin e të rinjve, ku ndryshimet e këtij ligji krijojnë programe të reja dhe sjellin risi për programet aktuale.

- Programi i Nismave Komunitare - Grupe joformale me mbi katër të rinj, të cilët kanë një projekt ose ide që i shërben komunitetit ku ata jetojnë, do të kenë mundësinë që ta zhvillojnë atë duke siguruar financim nga Qeveria shqiptare.
- Programi i Talenteve Rinore do të ofrojë mbështetje për të rinjtë e dalluar, duke mbuluar shpenzimet për pjesëmarrjen e tyre në kompeticione ndërkombëtare duke përfaqësuar Shqipërinë në art, kulturë, shkencë dhe sport.
- Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të sjellë risi duke garantuar trajtim ushqimor dhe trajnime profesionale në fushën e Administratës Publike për të rinjtë që do të zhvillojnë praktikën tre-mujore pranë institucioneve publike.

Po kështu, ligji parashikon fuqizimin e Qendrave Rinore dhe certifikimin e punonjësve rinorë, duke synuar që deri në vitin 2025 mbi 250,000 të rinj të përfitojnë nga këto mundësi. Ky ligj përfaqëson një hap të madh përpara në fuqizimin e rinisë shqiptare, duke ofruar më shumë mundësi dhe mbështetje për zhvillimin e tyre profesional dhe social.

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Mars



02

NËNSHKRIMI I KONTRATAVE ME BASHKITË FITUESE TË THIRRJES IV PËR GRANTE PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE – RITJE E HAPËSIRAVE FIZIKE DHE MUNDËSIVE PËR TË RINJTË

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përmes Thirrjes IV të shpallur përmes Agjencisë Kombëtare të Rinisë, nënshkroi kontratat me 6 bashkitë fituese të kësaj thirrjeje: Bashkinë Librazhd, Prrrenjas, Berat, Delvinë, Lushnje dhe Cërrik. Këto projekte do të ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e 34,771 të rinjve, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin e tyre me hapësira rinore moderne, biblioteka të reja, qendra teknologjike dhe infrastruktura për aktivitete në natyrë.

- Në Lushnje, do të ngrihet YOUTech, një qendër për të rinjtë, e fokusuar në teknologji dhe inovacion.
- Në Prrrenjas, do të krijohet qendra Digital Youth Hub për zhvillimin e aftësive digjitale.
- Në Cërrik, do të ndërtohet një bibliotekë moderne.
- Në Delvinë, një bibliotekë rinore do të ofrojë mundësi edukimi për të rinjtë e zonës.
- Në Librazhd, do të ndërtohet një park aventurash në Fushë Studën si një mundësi rekreative për të rinjtë.

Këto projekte përfaqësojnë një hap të rëndësishëm për përmirësimin e mundësive për rininë dhe për përfshirjen e tyre në zhvillimin e komunitetit.



03

PROGRAMI "SUPERSHKOLLAT" NË ELBASAN - NJË HAP MË PRANË BASHKËPUNIMIT RINOR TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Në Elbasan u zhvillua aktiviteti "Supershkollat", një program të cilin Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët e zhvillon me mbështetjen e RYCO, BE-së dhe GIZ, iniciativë e cila promovon shkëmbimin e eksperiencave mes të rinjve të Ballkanit Perëndimor. Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, së bashku me Komisioneren për Zgjerimin dhe Fqinjësinë e BE-së, Marta Kos, theksuan rëndësinë e këtij programi në ndërtimin e një rrjeti të përbashkët vlerash dhe bashkëpunimit mes të rinjve.

Në fazën e parë të projektit janë përfshirë 160 shkolla, 320 mësues dhe 2000 të rinj nga rajoni, ndërsa faza e dytë, projekti synon të zgjerohet më tej me 180 shkolla dhe mbi 3600 të rinj të angazhuar. Programi "Supershkollat" luan një rol kyç në ndërtimin e paqes dhe mirëkuptimit mes të rinjve, duke krijuar lidhje të forta dhe të qëndrueshme midis shkollave të mesme në rajon përmes shkëmbimeve ndërshkollore dhe bashkëpunimit afatgjatë në Ballkanin Perëndimor.



MINISTRIA E SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT
KOMISIONAT E RINISË
MINISTERIAL INSTITUTION FOR YOUTH AND CHILDREN

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Mars



04

SHQIPËRIA NIS FAZËN E DYTË TË PROJEKTIT "RINIA PËR PËRFSHIRJE, BARAZI DHE BESIM" - MBËSHTETJE 4.75 MILION DOLLARË PËR TË RINJTË E RAJONIT

Me një mbështetje prej 4.75 milion dollarësh, Shqipëria nis fazën e dytë të projektit rajonal "Rinia për Përfshirje, Barazi dhe Besim", një iniciativë që synon fuqizimin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor. Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, dhe Koordinatorja e OKB-së në Shqipëri, Fiona McCluney, bashkëdrejtuan një mbledhje kyçe mbi këtë projekt, i cili tashmë ka angazhuar mbi 14,000 të rinj në ndërtimin e besimit dhe dialogut ndërkulturor. Faza e re e projektit, në bashkëpunim me agjencitë e OKB-së në Shqipëri, UNDP, UNFPA, UN Women dhe UNESCO, do të fokusohet në rritjen e përfshirjes sociale, mbështetjen për barazinë gjinore, si dhe krijimin e hapësirave të reja për dialog dhe bashkëpunim mes të rinjve. Ky është një hap i rëndësishëm për rininë shqiptare drejt një rajoni më të lidhur, bashkëpunues dhe të hapur ndaj mundësive të përbashkëta.



05

PANAIRI "PUNO DHE JETO ATY KU KE ZEMRËN" NË GREQI - MUNDËSI PUNËSIMI PËR TË RINJTË SHQIPTARË

Në datën 2 mars, u zhvillua Panairi i Punës "Puno dhe Jeto, Aty ku ke zemrën" në ambientet e Technopolis në Athinë. Ky panair ishte një iniciativë e rëndësishme e Qeverisë Shqiptare, nën kujdesin e Kryeministrit Edi Rama, me qëllim lidhjen e diasporës shqiptare me tregun e punës në Shqipëri. Gjatë aktivitetit, 120 kompani shqiptare ofruan rreth 3,000 vende pune në sektorë të ndryshëm në Shqipëri, duke ofruar mundësi të rëndësishme për të rinjtë dhe profesionistët shqiptarë që jetojnë në Greqi.

Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, bashkë me ekipin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, zhvilluan takime me të rinjtë shqiptarë, duke i informuar për mundësitë që ofrojnë programet për rininë në fushën e edukimit dhe punësimit, si Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, Garancia Rinore dhe Be-Ja Për Rininë.



DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Mars



06

PËRURORHET QENDRA RINORE NË LIBRAZHË – 1000 TË RINJ DO TË KENË HAPËSIRËN E TYRE

Librazhdi ka tashmë një Qendër të Re Rinore, e cila do t'u ofrojë mundësi të reja rreth 1000 të rinjve të bashkisë. Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, përuroi këtë hapësirë të re, e cila vjen në sajë të mbështetjes nga Agjencia Kombëtare e Rinisë. Kjo qendër do të shërbejë si një pikë takimi dhe zhvillimi për të rinjtë, duke i ndihmuar ata të angazhohen në aktivitete arsimore, kulturore dhe profesionale. Gjithashtu, qendra do të jetë një hapësirë për nxitjen e ideve dhe pjesëmarrjen aktive në proceset vendimmarrëse lokale përmes Këshillit Vendor Rinor.



07

KONFERENCA "ZËRAT E GJENERATËS SË RE PËR EVROPËN" – FUQIZIMI I RINISË DHE PERSPEKTIVA EVROPIANE

Në Tiranë u mbajt konferenca "Zërat e Gjeneratës së Re për Evropën", bashkëorganizuar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministër i Shtetit Për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Fondacioni Karlspreis, një organizatë prestigjioze evropiane e lidhur me Çmimin Ndërkombëtar "Karl der Grosse" të Aachen-it. Ky event mbledhi 25 të rinj nga Bashkimi Evropian dhe të rinj shqiptarë, duke përfshirë diskutime frymëzuese me personalitete të njohura evropiane, si ish-Presidenti i Parlamentit Evropian, Martin Schulz, kryetari i bordit të "International Charlemagne Prize", Jürgen Linden, dhe aktivistja bjelloruse, Veronica Tsepkalo.

Në këtë aktivitet, diskutimet u fokusuan në shkëmbimin e eksperiencave, dialogun dhe bashkëpunimin ndërkulturore, si dhe integrimin evropian përmes fuqizimit të të rinjve.

Ministria Muzhaqi në fjalën e saj foli për ndryshimet në Ligjin "Për Rininë", i cili tashmë do të sjellë më shumë mundësi dhe përfaqësim për të rinjtë shqiptarë, duke i bërë ata aktorë kyç në vendimmarrje. Në Këshillat Vendorë Rinorë dhe Këshillin Kombëtar Rinor do të sigurohet përfshirje e plotë e të rinjve, duke garantuar përfaqësim për të rinjtë me nevoja të veçanta, ata nga grupet e marginalizuara, diaspora dhe grupmosha 15-18 vjeç. Ky ndryshim i mundëson çdo të riu të ketë një zë në vendimmarrjen lokale dhe të jetojë në kushte barazie, njëjtë me mundësitë që ofrohen për të rinjtë e vendeve të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, ajo theksoi se rinia shqiptare dhe evropiane janë forca lëvizëse për ndryshimin dhe integrimin e përbashkët, duke shtuar se Shqipëria falë progresit të arritur në negociatat me Bashkimin Evropian synon anëtarësim sa më të shpejtë në Bashkimin Evropian.



MINISTRIA E SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT
Këshillat Vendorë Rinorë dhe Këshilli Kombëtar Rinor

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Mars



08

18 TË RINJ NISIN KARRIERËN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE, PRANË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Ministrja Bora Muzhaqi, së bashku me Ministren Anila Denaj, zhvilluan një takim me 18 të rinjtë e përzgjedhur nga Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, të cilët janë të punësuar pranë aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Të rinjtë ndanë përvojat e tyre dhe shprehën interesin mbi zhvillimin e një karriere të qëndrueshme në administratën publike.

Programi i Praktikave të Punës, për të rinjtë që e aspirojnë, falë ndryshimeve në Ligjin "Për Rininë" do të sjellë risi duke ofruar mbulim të shpenzimeve dhe trajnime profesionale, për të lehtësuar integrimin në tregun e punës. Ministrja Muzhaqi ndau mesazhin e saj duke i ftuar të rinjtë të shfrytëzojnë mundësitë e Programit dhe të nisin rrugën drejt një karriere të suksesshme!